



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201601989/2

Tiranë ___/___/2016

Lënda: *Rekomandim për pajisjen me libra falas të fëmijëve të komunitetit egjyptian të shtetases M. L., në shkollën "Azem Hajdari", Babrru, Tiranë*

Drejtuar: Znj. Ermion Çekani
Zyra Arsimore

Kamëz

Për dijëni: Z. Plarent Ndreca
Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Arsimit

Tiranë

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit është dorëzuar ankesa e shtetases M. L., e cila është e komunitetit egjyptian ku na informon se pavarsisht se ka rreth me shumë se një muaj që ka filluar shkolla fëmijët e saj nuk janë pajisur me libra nga drejtori shkollës "Azem Hajdari", Babrru, Tiranë.

Në mbështetje të nenit 16 të Kushtetutës ku parashikohet se "Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë" si dhe pikës 3, të nenit 57, të Kushtetutës ku parashikohet se "Arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë", dhe në zbatim të nenit 16, të ligjit 10347 datë 04.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve", ku parashikohet se "Fëmija ka të drejtë të arsimohet në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me nivelin e zhvillimit mendor dhe fizik të tij.", çdo fëmijë, gëzon të drejtën për tu arsimuar.

Gjithashtu në zbatim të VKM nr. 707, datë 28.8.2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 107, datë 10.2.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar. dhe Udhëzimit Nr. 16, datë 3.8.2016 për vitin shkollor 2016–2017 në sistemin arsimor parauniversitar të gjithë fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian gëzojnë të drejtën për tu pajisur me libra falas.

Në zbatim të nenit 21 të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar “*paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”;

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave për paisjen me libra shkollorë falas për fëmijët e shtetasës së komunitetit egjiptian M. L., të cilët arsimohen në shkollën “Azem Hajdari”, Babrru, Tiranë, mbështetur ne legjislacionin ne fuqi.

Në zbatim të nenit 22 të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar detyrimi i organeve të administratës për t’ju përgjigjur institucionit të Avokatit të Popullit është brënda 30 ditësh nga data e dërgimit të shkresës zyrtare.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI